

## RELACION ARGUMENTIMI

### OBJEKTI: ” Rikonstruksion Kanali Ujitës Rezervuari Qafë Thanë-Boqezë ”

#### I. TË DHËNA TË PËRGJITSHME

Kanali Ujitës Rezervuari Qafë Thanë-Boqezë ndodhet në Njesinë Administrative Udënisht, fshati Boqezë. Skema ujitëse e rezervuarit Qafë Thanë - Kanali ujitës për fshatin Boqezë ka mbi 20 vjet që nuk funksionon për shkak të bllokimit të rezervuarit dhe kanalit përgjatë përroit-tunelet –Boqezë plotësisht i amortizuar.

Fshati Lin-Boqeze nuk ka burim tjetër ujitës përveç rezervuarit Qafë-Thanë. Kjo skemë ujitëse bëhet funksionale me ndërtimin e kanalit ujitës. Më parë si kanal ujitës ka funksionuar përroi me gjatësi 2 kml dhe pas tij kanali me gjatësi 1.6 kml pra gjithsej 3.6 kml. Humbjet në këtë rrugë ishin shumë të mëdha duhej një javë që kjo të arrinte tek tokat bujqësore.

#### II. GJENDJA EKZISTUESE

##### a) Të dhëna demografike.

Fshati Lin-Boqezë nuk ka burim tjetër ujitës përveç rezervuarit Qafë-Thanë. Nëpërmjet kësaj skeme ujitëse do të ujiten 50 Ha tokë fushë e mbjellë me kultura të ndryshme dhe përfitojnë rreth 100 familje.

##### b) Të dhëna për infrastrukturën.

Kanali ujitës për fshatin Boqezë ka mbi 20 vjet që nuk funksionon për shkak të bllokimit të rezervuarit dhe kanalit përgjatë përroit-tunelet –Boqezë

Problematika:

- Kanali është plotësisht i amortizuar.
- Humbjet në këtë kanal janë shumë të mëdha .
- Koha kur uji duhet të shkojë në tokat bujqësore është afërsisht rreth 1 javë.

Për të gjitha këto, por edhe probleme të tjera lind e domosdoshme ndërhyrja me fonde publike për zbatimin e projektit të rikonstruksionit të këtij kanali ujitës e cila është e përfshirë në objektivat e programit të parashikuar në prioritetet e qeverisjes vendore për të bërë të mundur që edhe në këtë pjesë të zonës së banuar të krijohen kushtet për :

- a) Riaftësimin e ujitjes së kanalit Ujitës Rezervuari Qafë Thanë -Boqezë.
- b) Rritjen e prodhimeve bujqësore të arave, të frutikuturës dhe vreshtari për rrjedhojë edhe të ardhurat e fermerëve.

### **III. TË DHËNA SPECIFIKE**

- Gjatësi totale afro 2220 ml
- Gjerësia e kanalit varion deri 50-60 cm

Për realizimin e projektit me zërat të mësipërm nevojitet një fond prej **8,772,145** lekë me TVSH.

Investimi i kërkuar përvecse do të bëjë të mundur realizimin e objektit me gjithë elementët e tij, do të bëjë të mundur riaftësimin e kanalit ujitës me parametra bashkëkohore dhe përmirësim të kushteve të jetesës .

**Hartoi:**

**NDËRMARRJA E MIRËMBAJTJES SË INFRASTRUKTURAVE DHE PUNËVE PUBLIKE  
SEKTORI I UJITJE KULLIMIT**